

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-266/13

**Prishtinë,
17 Shtator 2014**

Në çështjen juridike të:

M. Z.

Mal i Zi

Pala ankuese/paraqitësi i kërkesës

Kundër

Nuk dihet

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe xxxx, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC /D/A/188/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17744), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 Shtator 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17744), i datës 13 shkurt 2013), pasi është marrë në mungesë të juridiksionit.
- 2- Kërkesa e M. Z., hidhet poshtë si e papranueshme.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 29 dhjetor 2006, M.Z. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar njohjen e së drejtës së tij pronësore mbi ngastrat kadastrale 4131/2; 4132/2 dhe 105 në Junik, Deçan, Zona Kadastrale Junik.. Ai ka kërkuar ri-posedimin e ngastrave të cilat më herët i kishte fituar përmes një vendimi të Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë (Drejtorisë për pronë dhe çështje ligjor) nr.140-461-112/97-01 të datës 23 qershor 1997. Sipas tij, paraqitësit të kërkesës i ishin ndarë ngastrat sipas kushteve të *“Ligjit për kushtet, mënyrë dhe procedurën e ndarjes së tokës bujqësore qytetarëve që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në territorin e Krabinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë”*.
2. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin nr. 140-461-112/97-01 të Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë të datës 23 qershor 1997. Vendimi është verifikuar negativisht nga KPA.
3. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se prona e kërkuar ishte humbur si rezultat i rrethanave në vitet 98/99 në Kosovë dhe se data e humbjes ishte 12 qershor 1999.
4. AKP-ja ka identifikuar fizikisht ngastrat nr. 4131/2 dhe 4132/2. Ngastra nr. 105 nuk është gjetur. Në lidhje me ngastren nr. 105, AKP-ja ka gjetur vendimin HPCC/D/176/2005/C të datës 30 prill 2005, të marrë nga Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore, me atë të së cilit urdhërohet që kjo pronë duhet t'i jepet paraqitësit të kërkesës M.Z.
5. Njoftimi është bërë nëpërmjet publikimit në Gazetën për njoftime nr. 2 dhe në Buletinin e zyrës së UNHCR-së për çështje pronësore.
6. Asnjë palë përgjegjëse në kërkesë nuk është paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive për të kontestuar kërkesën para përfundimit të afatit prej 30 ditëve.
7. Raporti i njoftimit i datës 20 shkurt 2008 ka konfirmuar se ngastrat nr. 4131/2; 4132/2 ishin verifikuar negativisht. Sekretariati Ekzekutiv ka siguruar me iniciativën e vet fletën poseduese pjesore nr. 919, të lëshuar nga Zona Kadastrale e Junikut, Komuna e Deçanit, Agjencia Kadastrale e Kosovës me datën 26 nëntor 2007, e cila tregon se ngastrat kadastrale janë të regjistruara në emër të ndërmarrjes shoqërore “Ereniku Gjakovë”.

8. Me vendimin KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shkurt 2013, Komisioni i për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) kishte vendosur që të refuzonte kërkesën me arsyetimin se:
- Prona e kërkuar i ishte ndarë paraqitësit të kërkesës në bazë të *“Ligjit për kushtet, mënyrë dhe procedurën e ndarjes së tokës bujqësore qytetarëve që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në territorin e Krabinës Autonome të Kosovës dhe Metobisë”*, i cili ishte shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/10 të datës 13 tetor 1999, mbi bazën e të qenit ligj diskriminues;
 - Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur prova të tjera në mbështetje të kërkesës së tij;
 - Prona është e regjistruar në emër të ndërmarrjes shoqërore “Ereniku Gjakovë”, si pronar i ligjshëm.
9. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 16 gusht 2013.
10. Më 30 gusht 2013, paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke e kundërshtuar vendimin e KKPK-së. Ai pretendon shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës civile dhe administrative, zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, të drejtave të njeriut dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Nëpërmjet ankesës së tij ai ka kërkuar nga Gjykata Supreme që të miratojë kërkesën dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim në shkallë të parë.

Pretendimet e palës ankuese:

11. Pala ankuese deklaron se e kishte fituar pronën e kërkuar me vendim të organit shtetëror. Prandaj, ai pretendon të drejtën e kompensimit.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

13. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, Komisioni ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që lidhen me konfliktin e viteve 1998/1999, që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore të cilat nuk

mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

14. Bazuar në faktet e vërtetuara, duhet të pranohet se humbja e pretenduar e pronës nuk lidhet me Juridiksionin e KPPK-se. Pala ankuese pretendon se pronën dhe të drejtën pronësore mbi pronën e kishte fituar në bazë të vendimit nr. 140-461-112/97-01 të Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë të datës 23 qershor 1997. Në dispozitivin e këtij vendimi parashikohet se: *“Toka e ndarë sipas këtij vendimi nuk mund të shitet, ndahet, jepet me qira apo të tjetërsobhet në ndonjë mënyrë tjetër nga përfituesi brenda 30 viteve”*. Gjykata Supreme vëren se e drejta pronësore nuk është transferuar, por prona e cila është pronë shoqërore i ishte dhënë përfituesit për qëllim shfrytëzimi, si usufukt. Në këtë kontekst, pala ankuese nuk ka legjitimitet që të kërkojë të drejtën pronësore mbi ngastrat e kërkuara. E drejta e tij pronësore mbi këtë pronë shoqërore është revokuar me shfuqizimin e *“Ligjit për kushtet, mënyrë dhe procedurën e ndarjes së tokës bujqësore qytetarëve që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në territorin e Krabinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë”*, me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/10 të datës 13 tetor 1999.
15. Pas verifikimit nga ana e Sekretarisë Ekzekutive të fletës poseduese nr. 919, të lëshuar nga Zona Kadastrale e Junikut, Komuna e Deçanit, Agjencia Kadastrale e Kosovës me datën 26 nëntor 2007, ka rezultuar se prona e kërkuar është regjistruar në emër të ndërmarrjes shoqërore “Ereniku Gjakovë”, si pronë shoqërore. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KPPK-ja ka kompetencë që të zgjidhë të drejtën pronësore në lidhje me kërkesat për *pronë private* dhe kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtat e shfrytëzimit në *lidhje me pronën private*. Prona objekt i mosmarrëveshjes nuk ka qene prone private, por tokë në pronësi shoqërore. Prandaj, vendimi i KPPK-së duhet të anulohet pasi është marrë në mungesë të juridiksionit.
16. Sa i përket kompensimit të kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në ankesën e tij drejtuar Gjykatës Supreme, Paneli ka vlerësuar se kjo çështje nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme. Siç është përmendur më sipër, Gjykata Supreme ka kompetencë që të zgjidhë kërkesat që lidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999, kërkesa këto që kanë të bëjnë me të drejtat që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
17. Bazuar në sa më sipër dhe në përputhje me dispozitën e nenit 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 198, paragrafit 1 të Ligji mbi Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 12,2 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetar i trupit gjykues

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it